



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 3259/12 Prot.

Gramsh, më 23/05/2018

V E N D I M

Nr. 41 , datë 22/05 /2018

MBI

**MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE
PYJORE/KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH**

Këshilli i Bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 22.05.2018 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005, "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", i ndryshuar në mbështetje të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar, bazuar në nenin 54 gërma e, e ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Udhëzimin nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", në VKM nr.433 datë 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 3 gërma ç, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, neni 23/4, si dhe neni 54 gërma "k" e tij: Këshilli i Bashkisë:

V E N D O S I :

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Gramsh, sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes.

**SEKRETARI I KËSHILLIT
ASTRIT DUZHA**

Konceptoi A. Duzha
Pranoi Sh. Hoxha
Miratoi Sh. Hoxha
Konfirmoi
Dosja Nr. _____
Afati i ruajtjes RHK



**KRYETARI I KËSHILLIT
SHKËLQIM HOXHA**